



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:019464

Datë: 03.07.2024

Numri i dokumentit: 05894512

C.nr.70/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.H nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson Av. Sh.M-S nga Mitrovica, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria për Personel, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me bazë juridike kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 1,507.50 euro, jashtë seancës, më datën 03.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.H nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria për Personel, Prishtinë, që paditësit N.H, në emër të pagës së 13-të, në shumën prej 502.50 Euro, për vitet 2019, 2020, 2021, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,507.50 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 31.01.2021 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit N.H, t'i paguajë shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi N.H, më datën 31.01.2022, nëpërmjet përfaqësueses së tij të autorizuar, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria për Personel, Prishtinë, ka parashtruar padinë për kompensimin e shpërblimit jubilar, e precizuar me parashtresën e datës 26.04.2024, vlera e kontestit në shumë prej 1,507.50 euro.

Paditësi në padi ka theksuar se tek e paditura është në marrëdhënie, ndërsa se në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, të njëjtit i takon shpërblimi i një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund

të vitit dhe atë për vitin: 2019, 2020 dhe 2021, gjithsej 3 paga. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria për Personel, Prishtinë, në përgjigjen e saj në padi të datës 05.04.2022, ka theksuar se e kontestojnë padinë në tërësi sa i përket kërkesëpadisë së paditësit. Nuk është kontestuese fakti se paditësi është marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimin e lëshuar nga e paditura, mirëpo kërkesëpadinë e paditësit e kundërshton pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mjeteve financiare. Duke shtuar se paditësi në bazë të nenit 79 të Ligjit të Punës nuk i ka shtjerrur mjetet e brendshme të ankimimit. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa nëse gjykata e vlerëson të kundërtën i ka propozuar që kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontratën e punës, me Nr. Referencës: 07/1-01A/0637, të lidhur me datë 18.01.2019 ndërmjet paditësit N.H dhe të paditurës, kërkesën e paditësit për kompensimin e pagës së 13 drejtuar të paditurës; njoftimin e datës 29.12.2021, të lëshuar nga e paditura lidhur me kërkesës e paditësit; formularin e vlerësimit të performancës për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri me darën 31.12.2020 dhe vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura me Nr. ref. 04/ 01-08/SRR-427/2021, të datës 23.07.2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa shpërblimit jubilar.

Me administrimin e Kontratës të punës, me Nr. Referencës: 07/1-01A/0637, të lidhur me datë 18.01.2019 ndërmjet paditësit N.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.H ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në Policinë e Kosovës.

Me administrimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e pagës së 13 drejtuar të paditurës dhe njoftimin e datës 29.12.2021, të lëshuar nga e paditura lidhur me kërkesës e paditësit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi N.H i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e pagës së 13-të, ndërsa e paditura e ka refuzuar kërkesën e tij lidhur me kompensim.

Me administrimin e formularit të vlerësimit të performancës për periudhat kohore nga data 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020, si Polic i ri – Praktikant, në DRP Gjakovë paditësi N.H është vlerësuar me notën plotësisht e kënaqshme (4).

Nga vërtetimi i punësimit me Nr. ref. 04/ 01-08/SRR-427/2021, të datës 23.07.2021, të cilit gjykata ju fali besimin me rastin e vendosjes sa i për këtë lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, sepse nga i njëjti konstatoi se paditësi tek e paditura realizon pagë mujore në shumën 502,50 Euro.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të dhe kompensimin në emër të kualifikimit.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, i nxjerr nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim plotësisht të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësit.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të ia kompensoj paditësit, pagat e 13-ta, për fund vitet 2019, 2020 dhe 2021, për çdo vit jubilar. Andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit të ju kompensoi shumat e gjykuara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (16.04.2020), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit me pretendime se i njëjti në bazë të Ligjit të Punës nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim tek punëdhënësi në rastin konkret tek e paditura. Andaj në bazë të kësaj nuk i ka shtjerrur mjetet e brendshme të ankimimit. Gjykata këto pretendimet të paditësit i vlerëson të pabazuara për fakti se me administrimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e pagës së 13 drejtuar të paditurës dhe njoftimin e datës 29.12.2021, të lëshuar nga e paditura lidhur me kërkesën e paditësit, ka vërtetuar faktin se paditësi N.H i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin e pagës së 13-të, ndërsa e paditura e ka refuzuar kërkesën e tij lidhur me kompensim. Andaj në rastin konkret sipas dispozitave të lartcekura UA nr.02/2018, ekziston detyrimi i të paditurës që paditësin ta kompensojë në shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqituese, duke vendosur që paditësit t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.70/2022, më datën 03.07.2024

Bashkëpunëtorja profesional
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.